



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.09, datë 19.10.2022

PËR
KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË SIPËRFAQES SË NDËRTUAR PA LEJE
PËR QËLLIM FITIMI, NË OBJEKTIN “GODINË BANIMI DHE SHËRBIME 5, 7 DHE 9
KATE, ME 2 KATE PARKIM NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË RR. “KONT URANI”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Konfiskimin për interes publik të sipërfaqes prej 4552.2 m², të ndërtuar në tejkallim të lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.E-10778/6, datë 28.06.2017 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë banimi dhe shërbime 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rr. “Kont Urani”, Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërinë “ERE Architecture & Construction” sh.p.k, ndryshuar zhvilluesi në “Shoqëria “FABRI-D” sh.p.k dhe Z. Alban Bitraj”, me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.E-5103/3, datë 27.05.2019.
2. Planvendosja ku evidentohen pjesët takuese të cilat konfiskohen, si dhe pjesët takuese që mbeten në pronësi të zhvilluesit, të shprehura në sipërfaqe, volum dhe në të dhëna teknike, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti i autorizuar prej saj të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi në tejkallim të lejes së ndërtimit.



5. Bashkia Tiranë gjatë procedurës së lëshimit të certifikatës së përdorimit të parashikojë edhe pjesët e konfiskuara, të përcaktuara, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.
6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territor, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ju njoftohet palëve.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I BRENDSHËM

BLEDAR ÇUÇI



ANËTAR

MINISTËR I FINANÇAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

